



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 976/ prot.

Gjirokastrë, më 25.11.2025

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

KËSHILLIT TË BASHKISË PËRMET
Përmet

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendim nr. 97, datë 13.11.2025, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në VKB nr. 107, datë 18.12.2024 ‘Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Përmet viti 2025’”, konfirmohet.
2. Vendim nr. 98, datë 13.11.2025, “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bursat në zbatim të ligjit nr. 115/2024 ‘Për buxhetin e vitit 2025’, udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 ‘Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit’, VKB nr. 107, datë 18.12.2024 ‘Për miratimin e buxhetit të vitit 2025’, i ndryshuar, VKM nr. 511, datë 27.07.2022 ‘Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike’ dhe miratimin e listës emërore të nxënësve që përfitojnë bursa”, është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.
3. Vendim nr. 99, datë 13.11.2025, “Për përdorimin e fondit për emergjencat civile”, konfirmohet.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Albana Hasanaj